

**ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM TË PROVIMIT TË MATURËS NË GJIMNAZ, GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, QERSHOR 2016**

1. Është rrethuar numri 2. nga lisi nuk e sheh pyllin – **1 pikë**
2. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse shkruan: Fjalët kyçe përmbledhin shumë informacione dhe domethënie dhe mundësojnë të vendosen në një hapësirë të vogël/Ato minimizojnë sasinë e fjalëve, kurse rrisin sasinë e informacioneve/fjalët kyçe janë në të njëjtën kohë edhe zbrazje efikase për kujtesën/që të dallohet ajo që është me rëndësi (dhe përgjigje tjera të ngjashme)
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan që për dallim prej pjesës së parë dhe të dytë të tekstit pjesa e tretë përmban rregullat për krijimin e hartave të mendjes/mënyrën e hartimit të hartave/numërimin e rregullave/(dhe përgjigje tjera të ngjashme)
4. Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta:

| TEMA  | NË TEKST? |         |
|---|-----------|---------|
| Kur fjala kyçe duhet të nxirret nga përmbajtja e ligjëratës | Saktë     | Pasaktë |
| Kur me besnikëri duhet shënuar të gjitha fjalët e mësuesit  | Saktë     | Pasaktë |
| Si të krijohet harta e mirë e mendjes                       | Saktë     | Pasaktë |

5. Nxënësi merr **1 pikë** nëse e përshkruan ose perifrazon tekstin: “Harta e mendjes punëson të gjitha aftësitë mendore: aftësitë asociative dhe imagjinuese të memories tuaj; fjalët, numrat, regjistrat, vargjet, logjikën dhe analizën e hemisferës tuja të majtë të trurit; ngjyrat, imagjinatën, tredimensionalitetin, ritmin, ëndrrën, fotografinë e përgjithshme dhe aftësitë hapësinore të hemisferës së djathtë...”
6. Është rrethuar numri 2. Për tjetërsimin e anëtarëve të qeverisë amerikane nga jeta e tyre private. – **1 pikë**
7. Është rrethuar numri 1. Që t'i relaksojë dhe t'i nxisë në një sponatnitet. – **1 pikë**
8. Është rrethuar numri 2. tregimi i fotografive

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

Fotografitë vunë në lëvizje ndjenjat e dashurisë dhe butësisë për më të dashurit dhe nxitën kujtimet/Filluan t'i shkëmbejnë fotografitë dhe të bisedojnë për fëmijët e vet, nipat, domethënë për jetën e vet private (dhe përgjigje tjera të sakta) – **1 pikë** për përgjigjen e rrethuar dhe të argumentuar saktë.

(**Vërejtje:** Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar fare argumentimi – **0 pikë.**)

9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse përkthuan ose perifrason tekstin: “...shërben për depozitimin e jetës”/ për ruajtjen dhe depozitimin e jetës/Kuletat e tyre në të vërtetë janë vend çikërrimash ku gjenden gjërat e rëndësishme nga jeta e tyre private (dhe përgjigje tjera të sakta)

10. Është rrethuar numri 1. Vjollca – **1 pikë**

Presja vendoset pas emrit Vjollca dhe në këtë rast shërben për të vënë në dukje fjalën në rolin e gjymtyre të veçuar

(**Vërejtje:** Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar fare argumentimi – **0 pikë.**)

11. **A) Raskolnjikovi – 1 pikë**

**B) Të fillojë prej fillimit (dhe përgjigje tjera të sakta) – 1 pikë**

12. Përshkrimi i dhënë paraqet refleksionin e kryepersonazhit për ngjarjen e ndodhur dhe e arsyeton krimin nëse ai është bërë si rishikim i të qenit njeri (dhe përgjigje tjera të sakta) – **2 pikë**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse tregon vetëm se përshkrimi i dhënë paraqet refleksionin e kryepersonazhit për ngjarjen e ndodhur dhe e arsyeton krimin pa sqaruar nëse ai është bërë si rishikim i të qenit njeri.

13. **A) Krimi dhe pasojat e tij – 1 pikë**

**B) Metaforës – 1 pikë**

14. Një numër sonetesh u shkruan nga Petrarka – **1 pikë**

15. Është rrethuar numri 3. Erdhi nga qyteti. – **1 pikë**

16. Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta:

D.M.TH. (d.m.th.)

OKB

NATO

ETJ. (etj.)

17. Nxënësi merr **2 pikë** për rrethimin dhe argumentimin e saktë të përgjigjes:  
Është rrethuar PO.

Uniteti i veprimit ekziston sepse veprimi zhvillohet pa episode dhe digresion/Të gjitha ngjarjet lidhen me konfliktin dhe shprien në zgjidhjen e tij;

Uniteti i kohës ekziston sepse zhvillimi i Antigonës zgjat një ditë;

Uniteti i vendit ekziston sepse gjithçka zhvillohet në Ty.

(dhe përgjigje tjera të sakta) – **2 pikë** për rrethimin dhe argumentimin e saktë të përgjigjes.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse e ka rrethuar saktë përgjigjen dhe ka argumentuar saktë dy unitete të dramës në vepër.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar saktë përgjigjen dhe ka argumentuar saktë një unitet të dramës në vepër.

(Vërejtje: Nxënësi merr **1 pikë/2 pikë** nëse nuk e ka rrethuar PO, por e ka argumentuar saktë përgjigjen. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar vetëm se ekziston uniteti i vendit, veprimit dhe kohës.)

18. Figura e gruas – **1 pikë**

19. “Fjalët e qiririt”, Naim Frashëri – **1 pikë**

**0 pikë** – nëse ka shkruar vetëm titullin e poezisë ose vetëm emrin dhe mbiemrin e autorit.

20. A) Është rrethuar numri 3. t’u prijë shqiptarëve në idealet e tyre të çlirimit e të përparimit – **1 pikë**

B) Andaj po digjem si trimi, ose ndonjë varg tjetër që tregon për dëshirën e poetit për t’u prijë shqiptarëve në idealet e tyre të çlirimit e të përparimit (Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi shkruan dy vargje nga poezia e dhënë ose nëse e nënvizon atë në poezi.) – **1 pikë**

21. A) Kur më shihni se jam tretur

Mos pandehni se kam vdekur

Jam i gjallë e jam ndë jetë – **1 pikë**

B) Nxënësi ka sqaruar domethënien e epitafit: Epitafi është një varg apo vjershë që kryen funksionin e mbishkrimit në varr dhe që përmes tij autori shpreh veçoritë kryesore të personit për të cilin shkruhet.  
– **2 pikë**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse sqarimi nuk është i plotë, por edhe nëse ai është i saktë por që përgjigja nuk është me stil ose që ka gabime gramatikore, përkatësisht drejtshkrimore.

22. A) *Plaka Nicë personifikon nënat e martirizuara gjatë luftës – 1 pikë*  
B) *Vrasja e burrit dhe përdhunimi i vajzës – 1 pikë*

23. Nxënësi merr **2 pikë** për pesë përgjigje të sakta:

1. *Epi i Gilgameshit*
2. *Komedia hyjnore*
3. *Tartufi*
4. *Albatrosi*
5. *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo*

Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një ose dy përgjigje të sakta.

24. Është rrethuar numri 3. *renesancës – 1 pikë*

25. Është rrethuar numri 2. *metonimia*

Metonimia është figurë stilistike, kurse të tjerat janë lloje letrare  
(dhe përgjigje tjera të sakta) – **1 pikë**

(**Vërejtje:** Nxënësi merr **1 pikë** nëse nuk e ka rrethuar përgjigjen, por nga argumentimi është e qartë se mendon në Metonimi. Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar argumentimi **0 pikë**.)

26. Është rrethuar numri 3. *zhgënjimi – 1 pikë*

27. Është rrethuar numri 3. *shtyrja e aksionit – 1 pikë*

28. A) *Publicistik – 1 pikë*

B) Është rrethuar numri 3. *rruga e njohur – 1 pikë*

C) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përshkruar (ose ka nënvizuar në tekst):  
*Është një rrugë e cila kalonte pothuajse në trasenë e rrugës së vjetër “Egnatia”.*

(**Vërejtje:** Nuk pranohet nëse nxënësi përshkruan ose nënvizon të gjithë fragmentin.)

29. Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta:

| ROMANTIZMI  | REALIZMI         | LETËRSIA MODERNE |
|---|------------------|------------------|
| Aleksandër Sergejeviç<br>Pushkin<br>Johan Wolfgang Gëte | Honore de Balzak | Sharl Bodëler    |

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Në “Iliadë” mbretërojnë perënditë, por triumfon njeriu**

|                                     |  |
|-------------------------------------|--|
| <p><b>Kërkesa</b><br/><b>1.</b></p> | <p>Nxënësi tregon për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- bazën historike (viti i fundit i Luftës së Trojës (shekulli i 12 p.e.s.)/Lufta e Trojës – (dhe përgjigje tjera të sakta) – <b>1 pikë</b></li> <li>- temën e Iliadës (zemërimi i Akilit dhe mospjesëmarrja në luftë, që ushtrisë së Akejëve u shkaktonte humbje të mëdha/pezmatimi i Akilit dhe rrëfimi për Luftën e Trojës (dhe përgjigje të ngjashme të sakta) – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>   |
| <p><b>Kërkesa</b><br/><b>2.</b></p> | <p>Nxënësi përshkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Akilin si heroin më të madh të Akejëve, me të cilin drejtojnë ndjenjat; zgjedh një jetë të shkurtër dhe të lavdishme, hidhërohet, qan, është i pikëlluar për mikun e tij Patroklin, por që i vjen keq edhe për armikun – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hektorin – heroin më të madh të trojanëve, luftëtarin për atdheun, bashkëshortin dhe babanë e butë – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perënditë janë ata që drejtojnë me luftën; ata u ndihmojnë edhe Akejëve dhe Trojanëve, janë të plotfuqishëm, pa ndihmën e tyre nuk mund të ndodhë asnjë vepër heroike; gjithashtu janë edhe kryelartë, sikurse njerëzit: hakmerren, falin...- dhe përgjigje tjera të sakta – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Figurat e femrave: Helenën e bukur bukurinë e të cilës e admirojnë të gjithë dhe e respektojnë, nuk ia marrin për të madhe asnjë Trojani që për shkak të saj derdh gjakun (<b>1 pikë</b>) dhe Andromakën – gruan e dashur dhe nënën...dhe përgjigje tjera të sakta ... – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 9 pikë</b></p> |
| <p><b>Kërkesa</b><br/><b>3.</b></p> | <p>Nxënësi komenton vendet nga fragmenti i dhënë që kanë një fuqi të veçantë morale (p.sh. Njeriu i Homerit është zemërgjerë, me një shpirt kalorësi, i gatshëm ta respektojë kundërshtarin; t'i vlerësojë cilësitë e tij ; si shembull jep Priamin i cilin e admiron bukurinë e</p>   |

|                   |  |
|-------------------|--|
|                   | <p>Akilit, edhe pse ky ia ka vra djalin më të dashur dhe ia ka dhunuar trupin e tij, heroit më të madh të Trojës; Akili e ndal luftën aq ditë sa u nevojiten Trojanëve që ta varrosin hektarin <i>dhe përgjigje tjera të sakta</i>) – <b>1 pikë</b></p> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |
| <b>Kërkesa 4.</b> | <p>Nxënësi në përfundim tregon cilat porosi humane dhe vlera përmban ky fragment, përkatësisht ep (lirinë, trimërinë, nderin, miqësinë, bukurinë...) – <b>1 pikë</b></p> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>  |

### Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku   | Saktësia gjuhësore  | Lidhshmëria   | Struktura ndërtimore e tekstit   |
|---|---|---|--|
| <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> | <p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali,</p> | <p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p> |
| <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës,</p>   | <p>renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës</p>  |   |  |

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
| <p>figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>   | <p>drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> |  |  |
| <p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me</p>  |  | <p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p> |

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  | <p>gabime të pakta<br/>( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |  |  |
|--|--|--|--|

**Skema për vlerësimin e esesë: Lojërat e fatit – argëtim apo ves i keq**

|                   |   |
|-------------------|---|
| <b>Kërkesa 1.</b> | <p>Nxënësi tregon për llojllojshmërinë e lojërave të fatit (lotaria, loto, ruleti, bastoret sportive...) dhe për karakteristikat e tyre – <b>1 pikë</b><br/><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i><br/><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>  |
| <b>Kërkesa 2.</b> | <p>Nxënësi sqaron mbi çfarë e bazojnë organizatorët e lojërave të fatit joshjen e tyre (p.sh. mbi premitë e mëdha, biletat e lira të lotarisë në të cilat mund të ketë qasje shumë të lehtë, reklamat agresive...) – <b>1 pikë</b><br/><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i><br/><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>   |
| <b>Kërkesa 3.</b> | <p>Nxënësi tregon për:<br/>- motivet sociale të pjesëmarrësve në lojërat e fatit (skamja, varfëria, të ardhurat modeste...) – <b>1 pikë</b><br/><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i><br/>- motivet psikologjike të pjesëmarrësve në lojërat e fatit (vetëmashtrimi për fitoren e madhe pa një mundim të madh, ëndërrimi për një fat të papritur...) – <b>1 pikë</b><br/><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i><br/><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> |
| <b>Kërkesa 4.</b> | <p>Nxënësi sqaron qëndrimin e vet nëse munden ose jo lojërat e fatit që të ndikojnë në sistemin e vlerave (p.sh. sqaron ndikimin e tyre negativ në kuptimin e punës, krijimit, qëllimeve, përcaktimit/shkatërrojnë vlerat e proklamuar shoqërore/prodhojnë sëmundje të varshmërisë...) – <b>1 pikë</b></p>  |

|                          |   |
|--------------------------|---|
|                          | <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i><br/> <i>(Vërejtje: Nuk pranohet nëse nxënësi shkruan vetëm se ndikojnë ose nuk ndikojnë në sistemin e vlerave, por është me rëndësi që ta argumentojë qëndrimin e vet në mënyrë që të fitojë pikët)</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>          |
| <p><b>Kërkesa 5.</b></p> | <p>Nxënësi sqaron dhe argumenton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kur lojërat e fatit janë argëtim – <b>1 pikë</b></li> <li>- kur lojërat e fatit janë ves dhe varshmëri – <b>1 pikë</b></li> </ul> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |
| <p><b>Kërkesa 6.</b></p> | <p>Nxënësi në formë të përfundimit jep qëndrimin e vet kritik për lojërat e fatit – <b>1 pikë</b></p> <p><i>Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë – 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>  |

### Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku  | Saktësia gjuhësore   | Lidhshmëria   | Struktura ndërtimore e tekstit   |
|--|--|---|--|
| <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe</p> | <p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime</p> | <p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p> |

|  |   |  |  |
|--|---|--|--|
| <p>përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>        | <p>minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> |  |  |
| <p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p> | <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p>   |  | <p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p> |

|  |   |  |  |
|--|---|--|--|
|  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p> |  |  |
|--|---|--|--|